

BULETINI

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

Mr. sc. Rifat Zylfiu, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës

PAVLEFSHMËRIA E KONTRATAVE

(Nuliteti absolut dhe rrëzueshmëria)

Prishtinë, mars 2007

BULETINI

PAVLEFSHMËRIA E KONTRATËS
(Nuliteti absolut dhe relativ)
Vërejtjet paraprahe

Nocioni “pavlefshmëria e kontratës” është një shprehje abstrakte, e cila përfshin në vete format konkrete të pavlefshmërisë së kontratës, siç janë nuliteti dhe rrëzueshmëria, kurse termi tjetër për të njëjtën çështje është: nuliteti absolut dhe nuliteti relativ. Prandaj kur themi se një punë juridike është e pavlefshme, nuk kemi thënë se për cilën pavlefshmëri të kontratës është fjala.

Termi “pavlefshmëri” shërben për klasifikimin e kontratave, të cilat përmbajnë të meta të tilla për të cilave nuk mund të prodhojnë efektin juridik, të cilit i është destinuar. Ky term nuk ka përmbajtjen e vet. Prandaj Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), kur parasheh sanksionin për pavlefshmërinë e kontratës, nuk flet për pavlefshmërinë, por konkretisht parasheh nulitetin dhe rrëzueshmërinë. Dispozitat e LMD mbi pavlefshmërinë, përkatësisht nulitetin dhe rrëzueshmërinë e rregullojnë materien e kontratave, të cilat kanë të meta të caktuara, por dispozitat të cilat gjenden në seksionin mbi pavlefshmërinë e kontratave në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe te kontratat e tjera (neni 25 par. 3).

Nuliteti, përkatësisht rrëzueshmëria përbëjnë sanksionin juridik civil për kontratat që kanë të meta të caktuara, do të thotë për ato kontrata të cilat nuk janë lidhur ashtu siç e kërkon ligji, në kuptimin më të gjerë të fjalës, domethënë nuk i përgjigjen kërkesës së ligjit për kontratën juridikisht të vlefshme.

Prejardhja e kategorizimit. Në të drejtën romake nuk ka ekzistuar teoria mbi pavlefshmërinë e kontratës. Kur puna juridike ka pasur të meta të tilla për të cilat detyrimi në marrëdhëniet e detyrimeve nuk ka mundur të sajohet, bëhej fjalë për situatën nullum negotiorum – për zero obligatën. E drejta romake nuk e ka njohur gradacionin sipas peshës së të metave juridike të kontratës – nulitetin dhe rrëzueshmërinë, sepse sipas botëkuptimit të atëhershëm juridik ose ka ekzistuar ose fare nuk ka ekzistuar kontrata, prej asaj juridikisht asgjë nuk mund të ndahet diçka që do të mund të përfaqësonte më pak ose më shumë prej asaj asgjë.

Ndarja në dy apo tri gradacione të pavlefshmërisë është paraqitur më vonë në sistemet juridike më të zhvilluara. Tani mund të thuhet se sistemet bashkëkohore juridike, qoftë shprehimisht apo

implicite e pranojnë ndarjen bipartite të kontratave të pavlefshme në ato nule dhe të rrëzueshme edhe pse disa shkencëtarë përmendin edhe teorinë e kontratave inekzistente, e cila nuk ka ndonjë rëndësi praktike.

- 2

Kriteret e ndarjes në kontrata nule dhe të rrëzueshme

Në legjislacion dhe në praktikën e teorinë juridike mbizotëron botëkuptimi mbi ndarjen e kontratave të pavlefshme në kontrata nule (nuliteti absolut) dhe të rrëzueshme (nuliteti relativ). Ndarja e tillë bëhet sipas kriterëve (bazave) përkatëse.

Nuliteti përkatësisht rrëzueshmëria është sanksion i cili e godet kontratën e cila nuk i plotëson kushtet të cilat i kërkon rendi juridik për të mundur të prodhojnë efektin juridik të cilit i destinohen. Me sanksionin e tillë mbrohen interesat e rendit shoqëror të një shoqërie.

Nocioni i nulitetit dhe rrëzueshmërisë si instrument juridiko-teknik të mbrojtjes së interesave të caktuar në lëmin juridiko-civil është pranuar edhe në legjislacionin i cili është i aplikueshëm në Kosovë, përkatësisht në të drejtën civile të detyrimeve. Nuliteti, qëllimi i të cilit është mbrojtja e interesit të përgjithshëm është nuliteti absolut, ndërsa nuliteti, qëllimi i të cilit është mbrojtja e interesit individual, është nuliteti relativ përkatësisht rrëzueshmëria e kontratave.

Me rastin e vendosjes se a është fjala për nulitet absolut apo relativ, meqë ligji këtë nuk e ka rregulluar në mënyrë eksplicite, duhet filluar nga interesi të cilin ligji dëshiron ta mbrojë.

Rregullat për nulitetin absolut dhe relativ

Ndarja e kontratave në kontratat nule dhe të rrëzueshme ka rëndësi të madhe praktike, sepse disa rregulla vlejné për kontratat nule, ndërsa të tjerat për kontratat e rrëzueshme.

Dispozitat e përgjithshme mbi nulitetin

Me dispozitën e nenit 103 par. I të LMD kontrata nule definohet si kontratë e cila është në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat imperative (kogente) ose moralin shoqëror në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion ose në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parasheh diçka tjetër.

Çdo shtet me dispozitat kushtetuese dhe dispozitat tjera ligjore cakton se çka konsiderohet rend juridik –

ordër publik.

Kontrata e cila është në kundërshtim me rendin juridik sipas nenit 103 par. I të LMD është në kundërshtim me parimet fundamentale të së drejtës dhe rregullimit shoqëro, r të cilat mund të veçohen nga tërësia e dispozitave të aplikueshme.

Kështu, për shkak të palejuashmërisë së lëndës (neni 49 lidhur me nenin 47 të LMD, mund të jetë shpallur nule kontrata në kundërshtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese të Kosovës, rregullimin ekonomik dhe gjyqësor të Kosovës: kontrata sipas së cilës dikush do të ishte detyruar të agjitoonte në dobi të një kandidati të caktuar, dhe në atë mënyrë të ndikonte në përcaktimin e votueseve; kontrata sipas të cilës një punëtor udhëheqës i administratës ose ndërmarrjes publike do të detyrohej që ndaj personave të caktuar të ketë një qëndrim privilegjuës; kontrata sipas të cilës viktima e veprës penale do të detyrohej të mos paraqiste padi kundër kryerësit të veprës penale; kontrata me të cilën palët kontraktuese do të hiqnin dorë nga e drejta që kontestin në të ardhmen ta paraqesin në gjykatë ose do të merren vesh të ndryshojnë rregullat e procedurës gjyqësore, të cilat janë të natyrës kogente.

Nuliteti absolut i kontratave ekziston edhe në raste të tjera, të cilat nuk janë paraparë me dispozitën e neit 103. Ashtu siç është paraparë me nenin 47, ku bëhet fjalë për nulitetin e kontratës për shkak të lëndës, sipas të cilës është paraparë se kontrata është nule “kur lënda e kontratës është e pamundshme, e palejuar ose e pacaktueshme”, me nenin 52 në të cilën flitet për nulitetin e kontratës për shkak të bazës, ku thuhet se kontrata është nule “kur baza nuk ekziston ose është e palejuar”. Shkaqet e tjera të cilat mund të kenë si pasojë nulitetin absolut të kontratave mund të jenë:

- në raport me përmbajtjen: kontrata është nule jo vetëm “kur objekt i detyrimit i pamundur, i palejuar, i pacaktuar ose i pacaktueshëm” - neni 47 i LMD, por edhe atëherë kur i mungon objekti i detyrimit, (është kontraktuar shitja e sendit individualisht të caktuar, i cili në momentin e lidhjes së kontratës ka qenë i shkatërruar;
- në raport me vullnetin: nule është kontrata e cila është e lidhur nga personi të cilit i mungon plotësisht aftësia për të vepruar; ose nën dhunën fizike (vis absoluta), nëse dhuna fizike është e intensitetit dhe e natyrës së rëndë, që të mund të flitet për vullnetin e personit të shtrënguar atëherë as hije të kontratës nuk ka, p.sh. nënshkrimi i detyruar me lëvizjen e dorës së personit të shtrënguar; për dallim nga kjo, dispozita e nenit 60 flet për kërcënimin si shkak i nulitetit relativ;

- në raport me bazën (kauzën): kontrata është nule “në qoftë se nuk ekziston baza ose është e palejuar”;
- në raport me personin: kontrata është nule nëse është lidhur në emër të presonit juridikisht inekzistent;
- në raport me formën, siç parashihet me dispozitat e LMD, “pa efekt juridik” është kontrata që nuk është lidhur në formën e paraparë me ligj ose të kontraktuar duke paraparë rezervat nga neni 70 dhe 73 të këtij ligji.

Kontratat të cilat janë në kundërshtim me dispozitat imperative janë kontrata të kundërligjshme, kundër normës të cilën e përmban ligji apo akti nënligjor. Normat imperative nuk janë të formuluar në mënyrë të njëjtë. Kur dëshirohet të shprehet qëllimi i ligdhënësit për sanksionin, i cili pason në qoftë se palët nuk do t’u përmbahen dispozitave operative, përdoret termi “nule”, (p.sh. neni 50 lidhur me lëndën e detyrimit kur është i pacaktueshëm, 52 kur baza e kontratës nuk ekziston ose është e palejuar, 141 përkitazi me kontratën me fajde, 143 kur flitet për nulitetin e disa dispozitave të kushteve të përgjithshme) ose termi “kontrata nuk ka efekt juridik” (neni 53 lidhur me motivin për lidhjen e kontratës, 54 par. 3 që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit të palës së ndërgjegjshme të shkaktuar me lidhjen e kontratës, e cila nuk ka efekt juridik, etj. Nganjëherë ndalesa ligjore e lidhjes së kontratës në kundërshtim me dispozitën imperative shprehet me termin “nuk mund” – neni 364 ndalesa e kontraktimit të afatit të parashkrimit, ku thuhet se me punën juridike nuk mund të caktohet afati më i gjatë ose më i shkurtër i parashkrimit nga ajo kohë e cila është e caktuar me ligj. Pastaj neni 270 të LMD, sipas të cilit “kushti penal”, përkatësisht “ndëshkimi kontraktues” sipas të cilës me punën juridike nuk mund të kontraktohet ndëshkimi kontraktues (Kushti penal), etj.

Shprehjet me të cilat caktohet norma imperative nuk kanë gjithëherë të njëjtin kuptim. Ligji është shprehimor vetëm atëherë kur e përdor shprehjen “nule”, përkatësisht “e rrëzueshme”. Vetëm atëherë është e sigurt se puna juridike më të cilën cenohet norma imperative goditet me sanksionin juridiko-civil. Në rastet e tjera (është e ndaluar, nuk mund, medoemos dhe të ngjashme), ligji nuk flet shprehimisht se a do të shqiptohet dhe çfarë sanksioni juridiko civil do të shqiptohet. Kjo do të jetë çështje e gjykatës, e cila në bazë të interpretimit të kuptimit dhe qëllimit të ligjit të vendos për të.

Kontratat në kundërshtim me moralin. Kodet civile dhe ligjet mbi detyrimet e sistemeve juridike të shteteve si të atyre me sisteme të vjetra, ashtu edhe

të atyre me sisteme të reja juridike, përmbajnë dispozita mbi atë se punët juridike, të cilat janë në kundërshtim me botëkuptimet morale shoqërore, janë nule (nuliteti absolut). Botëkuptimet morale, të cilat me punët juridike nuk guxon të preken, në kodet civile ose në literaturë rëndom quhen “doke të mira”. Ato janë rregulla të moralit, të cilat në bashkësinë përkatëse shoqërore, në epokën e caktuar të zhvillimit, rregulla të vlefshme të sjelljes në marrëdhëniet e ndërsjella të subjekteve në qarkullimin juridik.

Doket e mira nuk janë të shprehura në tekstet ligjore për të qenë juridikisht relevante dhe për të prodhuar efekt juridik. Gjykata mund të vërtetojë përmbajtjen e tyre pavarësisht nga teksti ligjor, duke iu referuar normës së përgjithshme juridike mbi nulitetin e kontratës me të cilën është në kundërshtim.

Si shembull i kontratës amorale në praktikën e gjykatave dhe në literaturë përmendet kontrata sipas së cilës i premtohet dobia materiale personit të gjinisë femërore për shkak të sajimit ose mbajtjes së marrëdhënieve bashkëshortore, kontrata në bazë të së cilës, sipas dokeve të vjetra,

i jepej babës një shumë e caktuar e të hollave për t'u martuar vajza e tij për njeriun e caktuar. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se kuptimi i moralit shoqëror ndryshon me kalimin e kohës, ashtu që kontratat të cilat dikur kanë qenë në kundërshtim me moralin shoqërorë në një periudhë kohore, më vonë nuk janë konsideruar të tilla.

Kontratat lidhja e të cilave i ndalohet njëerës palë. Me nenin 103 par 2 të LMD është paraparë rasti i ndalesës së caktuar njëerës palë kontraktuese për lidhjen e kontratës së caktuar. Në qoftë se lidhja e kontratës iu ka ndaluar vetëm njëerës palë, kontrata do të mbetet në fuqi, në qoftë se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër për rastin e caktuar.

Ndalesa të cilat kanë të bëjnë me njëerën palë kontraktuese ka në legjislacionin ekonomik. Më së tepërmi u dedikohen shitësve – koha, vendi, dhe kushtet e shitjes mallit blerësve – konsumatorëve. Sanksioni i cenit të ndalesave të tilla nga personat të cilëve iu ka caktuar, është dënimi me të holla (për delikte ekonomike. Qëllimi i ligdhënësit është që t'i disiplinoj shitësit dhe t'i mbrojë konsumatorët.

Pasojat juridike të nulitetit të kontratave

Ekziston rregull e përgjithshme e cila ka të bëjë me të gjitha shkaqet e nulitetit të kontratës. Rregulla e tillë konsiston në detyrimin e palëve kontraktuese

që të kthejnë njëra-tjetrës krejt atë që kanë marrë sipas bazës së kontratës nule (neni 104 par. 1 të LMD). Kjo rregull pason logjikisht nga fakti se kontrata absolutisht nule në aspektin juridik përfaqëson një zero juridike dhe në qoftë se në përmbushjen e kontratës së tillë është dhënë, duhet të rivendoset gjendja e cila ka qenë para lidhjes së kontratës, sikur një kontratë e tillë të mos kishte ekzistuar fare. Kjo rregull vlen si te nuliteti absolut (neni 104 LMD), ashtu edhe te nuliteti relativ (neni 113 të LMD). Në qoftë se kjo nuk është e mundur ose natyra e saj që është përmbushur i kundërshtohet kthimit, atëherë do të jepet shpërblimi gjegjës në të holla sipas çmimeve në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse ligji nuk cakton diçka tjetër (neni 104 par. 1 të LMD).

Kjo rregull e përgjithshme, e cila logjikisht rezulton nga parimi i nulitetit në formën e qëndrimit parimor, ka ardhur në shprehje në praktikën e gjykatave, kështu që në një aktgjykim thuhet :”Kur kontrata e lidhur shpallet nule, çdonjëra palë është e detyruar të kthejë atë që ka pranuar nga pala tjetër, e në qoftë se për të nuk ka mundësi reale ose juridike, atëherë është e detyruar t’ia shpërblejë vlerën përkatëse”.

Retroaktiviteti i kthimit në gjendjen e mëparshme në raportet në mes të palëve kontraktuese në princip ka efekt në të drejtën e detyrimeve tek ne edhe ndaj personave të tretë, atyre të cilët kanë sajuar marrëdhënie kontraktuese dhe kanë fituar të drejta të caktuara në bazë të kontratës nule përkatësisht të kantatës së anuluar. Pasojat vijnë në shprehje më së tepërmi atëherë kur në bazë të kontratës nule ose të kontratës së anuluar është përmbushur bartja e së drejtës së pronës ose e ndonjë të drejte tjetër sendore. Në qoftë se p.sh. blerësi i paluajtshmërisë i ka shitur personit të tretë palujatshmërinë, nëse kontrata e parë anulohet, e drejta e pronësisë, të cilën ai ia ka bartur personit të tretë, humbet ipso facto/ Pasi që konsiderohet se kontrata nule përkatësisht ajo e anuluar asnjëherë nuk kanë ekzistuar, konsiderohet se blerësi nuk ka pasur kurrfarë të drejte në paluajtshmëri dhe nuk ka mundur në mënyrë të plotfuqishme të bartë të drejtën e pronës mbi personin e tretin. Ajo është pasojë e rregullës se askush nuk mund të bartë tek i treti më shumë të drejta sesa ka vetë dhe të retroaktivitetit : në qoftë se ka rënë e drejta e ati j që e ka bartur të drejtën, bie edhe e drejta e atij që iu ka bartur ajo. Sipas së drejtës së aplikueshme në Kosovë, në parim, e drejta e të tretit bie pa marrë parasysh se a ka qenë ky i ndërgjegjshëm apo i pandërgjegjshëm .

Mund të vërehet se kjo zgjidhje nuk është në pajtim me parimin e mbrojtjes së qarkullimit të ndershëm. Personat e tretë të ndërgjegjësimit do të jenë

gjithmonë në pasiguri se një ditë e drejta e paraardhësit juridik do të shpallet nule. Duhet përmendur se në disa sisteme juridike të shteteve të tjera (Gjermani, Zvicër, dhe në Itali) prioritet ka mbrojtja e parimit të mirëbesimit në raport me parimin e efektit retroaktiv të nulitetit të kontratës (retroaktivitetit). Edhe në të drejtën tonë ekziston korrektuesi i këtij parimi i cili formalisht nuk do të thotë se është hequr dorë nga efekti retroaktiv i kthimit në gjendjen e mëparshme, edhe pse në situata të caktuara juridike pengohet zbatimi i tij. Kjo do të ndodh atëherë kur të përmbushen kushtet për fitimin e pronës mbi sendin e luajshëm nga jopronari dhe kur të plotësohen kushtet për fitimin e së drejtës së pronës mbi sendin e paluajshëm me anë të parashkrimit fitues, por në të dy këto situata është fjala për fitimin e së drejtës së pronësisë në mënyrë origjinere.

Nga parimi retroaktiv i nulitetit hiqet dorë në rastet e parapara me ligj: me nenin 104 (për nulitetin absolut) dhe me nenin 113 (për nulitetin relativ) parashihen rastet që – në qoftë se në bazë të kontratës nule përkatësisht të anuluar diçka është përmbushur, “është e pamundur të bëhet kthimi” ose që “natyra e asaj që është përmbushur ekundërshton kthimin”. Situata të tilla do të ndodhin te kontrata me prestime sukcesive – kontrata e qirasë, ose kontrata e punës, nuk mund të kthehet “shfrytëzimi” i lokaleve të dhëna me qira; punëtori nuk mund të marrë punën e kryer, prandaj në këto situata nuliteti do të ketë efekt vetëm në të ardhmen.

Rikthimi në gjendjen e mëparshme është i njëanshëm kur nga kontrata nule njëra palë duhet të kthejë atë që ka marrë, ndërsa i dyanshëm është atëherë kur kontrata është përmbushur nga të dy palët kontraktuese dhe të dy palët duhet të kthejnë atë që kanë marrë sipas kontratës nule.

Nemo auditur propriam turpitudinem allegans – nuk duhet të dëgjohet ai që mbështetet në turpin e vet.

Nga rregulla e përgjithshme për rivendosjen e gjendjes së mëparshme ekziston përjashtimi në rastin kur dy palët lidhin kontratën me synim të realizimit të qëllimit të ndaluar. Kuptimi i kësaj maksime qëndron në atë se në qoftë se është fjala për kontratën e ndaluar dhe të dy palët kanë vepruar në mënyrë të pandershme – delikumente, kanë lidhur kontratën për realizimin e ndonjë qëllimi të palejuar, pala e cila e ka përmbushur prestimin e vet, nuk do të mundet, edhe pse kontrata është nule, t’i referohet nulitetit për të marrë prapa atë që i ka dhënë palës tjetër në përmbushjen e kontratës së palejuar. Ajo që në

përmbushjen e kontratës së tillë iu ka dhënë palës tjetër i mbetet palës tjetër – nuk kthehet. Kjo praktikisht do të thotë se askush para gjykatës nuk mund ta bazojë kërkesën e vet mbi një bazë të palejueshme – jo morale.

Megjithatë, në vend të kthimit në gjendje të mëparshme gjykata, mundet, në pajtim me nenin 204 par. 2 të LMD, të vendosë që vlera kontestuese nga transaksioni i palejuar të bartet në pronën publike – shtetërore përkatësisht të komunës.

Gjykata nuk është e kufizuar me asnjë rregull më parë të caktuar që do ta obligonte të veprojë në një mënyrë të caktuar. Gjykata është e autorizuar të marrë vendim që i përgjigjet më së tepërmi qëllimit të sanksionit. Gjykata do të ketë parasysh “mirëbesimin e njëres apo të dy palëve rendësinë e interesit të përgjithshëm që rrezikohet, botëkuptimet morale shoqërore (neni 104 par. 1).

Nuliteti i pjesshëm. Me dispozitën e nenit 105 të LMD parashihet se nuliteti i ndonjë dispozite të kontratës nuk ka për pasojë nulitetin e vetë kontratës, në qoftë se ajo mund të qëndrojë pa dispozitën nule dhe në qoftë se ajo nuk ka qenë as kusht i kontratës e as shtytës vendimtar, për të cilat kontrata është lidhur. Kontrata sipas rregullit është punë komplekse juridike dhe, si i tillë, mund të përmbajë numër të madh të dispozitave nga të cilat ndonjëra është thelbësore për ekzistimin e kontratës, ndërsa të tjerat janë sekondare. Në qoftë se nuliteti godet dispozitën e kontratës e cila është thelbësore për vetë ekzistimin e kontratës, atëherë e tërë kontrata është nule, prandaj nulitet absolut nuk mund të ketë. Kështu, në qoftë se dispozita mbi lëndën e kontratës së shitjes është nule për shkak se sendi është jashtë qarkullimit, atëherë e tërë kontrata është nule (neni 548), kurse, në qoftë se është nule ndonjë dispozitë sekondare ose joesenciale, p.sh. dispozita mbi kushtin penal, në rast të zgjidhjes së kontratës së shitjes me pagesën e çmimit në këste, ose kredisë, nuk do të ndikoj në vlefshmërinë e kontratës mbi shitjen apo kredinë.

Konversioni i kontratës është transformimi i një kontrate absolutisht nule në kontratë tjetër juridikisht të vlefshme. Kur kontrata nule i plotëson kushtet për plotfuqishmërinë e ndonjë kontrate tjetër, atëherë në mes të kontraktueseve do të vlejë kontrata tjetër, në qoftë se do të ishte në pajtim me qëllimin të cilin palët kontraktuese kanë pasur parasysh kur e kanë lidhur kontratën, sepse mund të merret se do ta kishin lidhur atë kontratë sikur të kishin ditur për nulitetin e kontratës së tyre (neni 106 i LMD). Për të ekzistuar konversioni i kontratës palët duhet të mos kenë pasur dijeni për nulitetin e kontratës së lidhur, përndryshe nuk do të mund të

flitej për konversionin. Në kontratën nule medoemos duhet të jenë përmbajtur elementet e kontratës së vlefshme. Për të qenë konversioni me kontratën tjetër të plotfuqishme të përmbajtur në kontratën nule, me doemos duhet të realizohet i njëjti ose përafërsisht i njëjti qëllim të cilin palët e kanë pasur parasysh kur kontratën e kanë lidhur, ashtu që mund të merret që ata do ta kishin lidhur atë kontratë sikur të kishin pasur dijeni për nulitetin. Do të thotë se palët këtë substitut e kanë dëshiruar. Në qarkullimin juridik raste të tilla të konversionit ekzistojnë në të drejtën trashëgimore kur p.sh. (testamenti publik nul mund të vlejë si testament privat në qoftë se janë plotësuar elementet për këtë të dytin); kontrata mbi cedimin dhe ndarjen e pasurisë për së gjalli nga paraardhësi është i pavlefshëm, për shkak se ndonjëri nga pasardhësit – trashëgimtarët e ardhshëm – nuk e ka dhënë pëlqimin, do të vlejë si kontratë e dhurimit për pasardhësit të cilët e kanë dhënë pëlqimin për kontratën e lidhur; në të drejtën e kambialit (kambiali i pavlefshëm do të vlejë si dokument mbi borxhin, cedimin e tj.).

Përgjegjësia e personit fajtor për nulitetin e kontratës

Me lidhjen e kontratë nule njëra apo pala tjetër mund të pësojnë dëm. Neni 108 i LMD parasheh se në kushte të caktuara, pala kontraktuese që ka pësuar dëm mund të kërkojë nga pala tjetër shpërblimin e dëmit. Për të ekzistuar detyrimi i shpërblimit të dëmit sipas kësaj dispozite duhet që njëra palë kontraktuese të jetë fajtorë për lidhjen e kontratës së tillë, të ekzistojë lidhja kauzale mes lidhjes së kontratës së tillë dhe dëmit të shkaktuar, që kontraktuesi i dëmtuar të jetë me mirëbesim, ai do të jetë i tillë në qoftë se nuk ka pasur dijeni për ekzistimin e shkakut të nulitetit të kontratës. Në qoftë se në mënyrë komulative plotësohen këto kushte, pala e dëmtuar fiton të drejtën për shpërblimin e dëmit.

Kush mund t'i referohet nulitetit absolut

Nga karakteri i nulitetit varet edhe rrethi i personave që mund t'i referohen atij. Të gjithë ata që kanë interes qoftë material apo moral që ndonjë kontratë të shpallet nule mund të paraqesë një kërkesë të tillë dhe të kërkojnë nga gjykata të marrë vendim përkatës.

Për nulitetin absolut, sipas nenit 109 të LMD, gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe këtij mund t'i referohet çdo person i interesuar. Persona

të interesuar mund të jenë në rend të parë palët kontraktuese, prandaj ata mund të paraqesin kërkesë për vërtetimin e nulitetit të kontratës.

Pengesë mund të ketë pala e pandërgjegjshme nëse janë përmbushur prestimet e ndërsjella nga kontrata, por në qoftë se nuk janë përmbushur, nuk ekziston pengesa që edhe pala e pandërgjegjshme të kërkojë vërtetimin e nulitetit të kontratës.

Në disa situata si persona të interesuar mund të paraqiten edhe personat e tretë, të cilët kanë interes juridik, siç janë suksesorët universalë apo singularë të kontraktueseve, kreditorët të cilët kanë interes juridik të kërkojnë që të vërtetohet nuliteti i kontratës.

Si persona të interesuar mund të paraqiten personat juridikë shoqërorë dhe organet e tyre, të cilët janë të autorizuar që të mbrojnë interesa të caktuara publike. Të drejtën e tillë e ka edhe prokurori publik.

Sipas detyrës zyrtare, duke pasur parasysh interesin publik, ligji e detyron gjykatën që të kujdeset ex officio për nulitetin, duke mos pritur që palët kontraktuese ose personat e tjerë të interesuar të kërkojnë vërtetimin e nulitetit. Kjo do të ndodhë kur palët kontraktuese kontestin e kanë paraqitur në gjykatë, duke mos paraqitur kërkesë për vërtetimin e nulitetit, qoftë për shkak se nuk kanë pasur dijeni për të, qoftë se atë e dëshirojnë për motive të ndryshme që atë ta heshtin.

E drejta për të kërkuar vërtetimin e nulitetit absolut nuk shuhet

Kjo çështje është rregulluar me dispozitën e nenit 110 të LMD. Në të theksohet se e drejta për paraqitjen e padisë për vërtetimin e nulitetit të kontratës nuk parashkruhet dhe se kontrata nule me kalimin e kohës nuk mund “të shërohet” dhe të bëhet e vlefshme.

Megjithatë, në disa sisteme kjo zgjidhje nuk është e pranueshme. Kështu, p.sh., në sistemin juridik të Francës parashikohet që të gjitha paditë, pra edhe padia për vërtetimin e nulitetit absolut të kontratës, parashkruhet në afat prej tridhjetë vjetësh (neni 2262 të Kodit Civil). Ky qëndrim mbrohet me atë se interesi i qarkullimit juridik, përkatësisht interesi publik është që me kalimin e një kohe të caktuar të stabilizohet gjendja faktike.

NULITETI RELATIV (PAVLEFSHMËRIA RELATIVE)

Kontratatt relativisht nule përmbajnë të meta, por të metat e tilla, nuk janë “të pashërueshme”, siç është rasti me kontratat absolutisht nule.

Në krahasim me efektin normal juridik të kontratës, ekziston e drejta e paraqitjes së padisë për anulimin e kontratës. Ngase kontrata relativisht nule prodhon

efekt juridik deri tek anulimi, aktgjykimi i gjykatës, nuk do të jetë i natyrës deklaratore, siç është rasti me kontratat absolutisht nule, por do të këtë karakter konstitutiv. Me aktgjykim të tillë kontrata anulohet me efekt retroaktiv. Për karakteristikat e tjera të kësaj kontrate që kanë të bëjnë me konvalidimin e saj nuk do të bëhet fjalë, ngase kjo do të jetë temë e veçantë.

Kur kontrata është relativisht nule (e rrzueshme)

Kontrata është relativisht nule kur e ka lidhur personi me aftësi të kufizuar për të vepruar, kur me rastin e lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje me vullnetin e palës, si dhe kur me ligj apo me ndonjë dispozitë të veçantë është caktuar.

Nuliteti relativ apo rrzueshmëria është sanksion juridiko-civil i cili është paraparë për mbrojtjen e interesit individual. Me këtë sanksion parimisht goditen kontratat të cilat janë lidhur nga personat me aftësi të kufizuar, pa lejen e përfaqësuesit ligjor (neni 56 par. 3 të LMD) dhe ato me rastin e lidhjes së të cilave ka ekzistuar ndonjë e metë relevante e vullnetit, (kontratat e lidhur në lajthim, nën kërcënim apo me mashtrim (neni 60-61 dhe 65).

Me dispozita të tjera janë paraparë rastet e nulitetit relativ, kur mes detyrimeve të palëve ekziston një shpërpjesëtimi evident, mund të kërkohet anulimi i kontratës (neni 139 të LMD), dëmtimi përtej mase (neni 140). Këtu theksohet se anulimin e kontratës mund ta kërkojë personi juridik-shoqëror i cili ka qenë palë kontraktuese si dhe organi kompetent (neni 140 p. 4). Nga kjo dispozitë rezulton se është fjala për kontratën relativisht nule dhe me paraqitjen e padisë mbrohet interesi individual.

Rrethi i subjekteve të cilët mund të thirren në pavlefshmërinë relative

Anulimin e këtyre kontratave mund ta kërkojë në radhë të parë pala kontraktuese në interesin e të cilës është konstatuara rrzueshmëria. Ky është parim që rezulton nga qëllimi i sanksionit. Por, këtë të drejtë e kanë edhe suksesorët e personit që i ka ata si dhe presoni i tretë, i cili ka ndonjë interes për t'u anuluar kjo kontratë. Sipas këtyre rregullave, pala kontraktuese, në interes të së cilës është lidhur kontrata e rënë, mund të kërkojë që kjo kontratë të anulohet (neni 112). Kontraktuesi tjetër mund të kërkojë nga pala që në afat të caktuar, por jo më pak se 30 ditë, të deklarohet se a ngel pranë kësaj kontrate që është relativisht e pavlefshme, sepse në të kundërtën do të konsiderohet se kontrata është anuluar (neni 112 p. 3 LMD). Në qoftë se pala

kontraktuese e ftuar në afat të caktuar nuk deklarohet ose nëse deklaron se nuk ngelë pranë kësaj kontrate, do të konsiderohet se kontrata është anuluar neni 112 p. 3 të LMD).

Bashkëkontraktuesi i personit me aftësi të kufizuar për të vepruar mund ta ftojë përfaqësuesin e tij ligjor që të deklarohet se a e pranon kontratën që e ka lidhur pa lejen e tij dhe në qoftë se ai në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të thirrjes, nuk deklarohet nëse e pranon ose jo, konsiderohet se ka refuzuar ta pranojë dhe kontrata e tillë mbetet edhe më tutje "e çalë" (negotium claudicans).

Pasoja juridike të anulimit të kësaj kontrate

Me anulimin e kësaj kontrate shkaktohen të njëjtat pasoja, sikurse edhe te kontrata absolutisht nule, të cilat i kemi përmendur më sipër, prandaj do të ishte e tepërt të përsëritën.

Shuarja e të drejtës për të kërkuar anulimin e kontratës relativisht të pavlefshme

Sipas nenit 117 të LMD e drejta për t'i paraqitur gjykatës padinë për anulimin e kontratës shuhet me kalimin e afatit subjektiv prej një viti nga dita e marrjes në dijeni për shkakun e nulitetit relativ, përkatësisht nga dita e pushimit të dhunës, përkatësisht në afatin objektiv prej tre vitesh nga dita e lidhjes së kontratës. Këto afate vlejnjë për shkak të mungesave të vullnetit e jo edhe për shkak të paaftësisë së kufizuar të palës kontraktuese, sepse për këtë të fundit afati fillon të ecë nga dita e fitimit të aftësisë për të vepruar dhe zgjat tre muaj (neni 59). Për kontratat lezionare afati është njëvjeçar (neni 139). Këto afate janë prekluzive.

LITERATURA E PËRDORUR:

1. Alajdin Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë, Prishtinë, 2002;
2. Dr. Mihajlo Konstantinovic, obligaciono Pravo, Beograd, 1959;
3. Milan Brkic, Zakon o obveznim odnosima, biljeske uz članove zakona o Medjusobnoj povezanosti;
4. Dr. Slobodan Perovic, Ugovor, Enciklopedija imovinskog prava i prava udruzenog rada, tom treci, Beograd, 1978;
5. Komentar Zakona o obligacionim odnosima, redaksia Dr. Slobodan Perovic, "Savremena Administracija, Beograd, 1995;
6. Komentar Zakona o obligacionim odnosima, redakcija: Dr. Borislav Blagojevic i Vrleta Krulj, "Savremena Administracija", Beograd, 1983 dhe
7. Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve "Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 29/78 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra g.z.39/85, 45/89, 59/89 dhe 31/89.

Ngjarjet e ardhshme

prill 2007

Seminar: Kodi i Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë

Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha gjykatave dhe prokurorive duke i përfshirë edhe gjyqtarët për kundërvajtje të regjionit të Pejës.

Ky trajnim ka për qëllim që të jap një pasqyrim të detajuar të përvojës dhe praktikës, ku mund të sfidohet pavarësia e gjyqtarëve. Ky seminar do të përqendrohet në përgjegjësinë e gjyqtarit dhe prokurorit për sundimin e ligjit dhe rendit në frymën e kodeve të mirësjelljes dhe sanksioneve disiplinore të cilat parashihen më këto kode. Element i ri që duhet të iu prezantohet pjesëmarrësve do të jenë teknikat për perfeksionimin e shkathtësive të gjyqtarëve më rastin e komunikimit me opinionin dhe mediat si dhe për risitë të cilat përfshihen në Kodin e Etikës.

Data e planifikuar: 2 prill 2007

Trajnim i shkathtësive praktike: Simulim

Grupi përfitues: Prokurorët dhe gjyqtarët e lëmisë penale

IGJK do të organizoj një simulim praktik për prokurorët dhe gjyqtarët e lëmisë penale. Këtë radhë është përzgjedhur një rast atraktiv i cili do të analizohet në grupe të ndara dhe më pasatj do të ketë debat lidhur me te. Vëmendje e veçantë do ti kushtohet nxjerrjes dhe shqyrtimit të provave si dhe arsytimit të vendimit.

Data e planifikuar: 5 prill 2007

Seminar: Ligji për Familjen

Grupi përfitues: Gjyqtarët e lëmisë civile

Instituti Gjyqësor i Kosovës do të organizoj një seminar nga lëmia civile (Ligji i ri për Familjen i Kosovës), i cili do të mbahet në IGJK në Prishtinë. Temat të cilat do të shtjellohen gjatë punës së këtij seminary kryesisht do të përqendrohen në çështjet që kanë të bëjnë me: Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, Procedurës së shkurorëzimit, Adoptimit dhe kundërshtimit të atësisë dhe amësisë. Gjithashtu vëmendje e veçantë në këtë tryezë do t'i kushtohet edhe vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zgjidhjen e rasteve civile në këtë lëmi sidomos pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Familjen i Kosovës.

Data e planifikuar: 06 prill 2007

Tryezë Diskutimesh: Konfirmimi i aktakuzës

Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve.

Instituti Gjyqësor i Kosovës do të organizoj një tryezë diskutimesh me temë “Konfirmimi i aktakuzës” në Prishtinë. Në këtë punëtori përmes rasteve dhe situatave të ndryshme do të prezantohen disa nga dilemat të cilat po e përcjellin procedurën e konfirmimit të aktakuzës. Qëllimi i kësaj tryeze është që të harmonizohet praktika gjyqësore gjatë konfirmimit të aktakuzës dhe të eliminohen dilemat që po e përcjellin këtë institut të rëndësishëm të procedurës penale. Nder situatat të cilat do të analizohen në këtë punëtori janë edhe ato: kur aktakuza hudhet si shkresë e rendomët, kur ndryshon kualifikimi i veprës penale, caktimi i paraburgimit , ndërprerja e paraburgimit etj.

Data e planifikuar: 10 prill 2007

Seminar, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit të Prishtinës.

IGJK do të vazhdoj trajnimet që ka filluar nga viti i kaluar në temën “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut” në rajonin e Prishtinës. Ky do të jetë sesion dy-ditor i cili mëton që të jap një pasqyrim të detajuar drejt zbatimit të dispozitave të KEDNJ, me qëllim të ngritjes së njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës drejt praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Katër trajnues vendor, gjyqtar dhe prokuror të cilët janë çertifikuar nga Këshilli i Evropës do të veprojnë në cilësinë e trajnuesve në këtë sesion.

Data e planifikuar: 12 dhe 13 prill 2006.

Tryezë Diskutimesh: Procedura e Provave

Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve.

Instituti Gjyqësor i Kosovës do të organizoj një tryezë diskutimesh me temë “Procedura e Provave” në Prishtinë. Përfitues të kësaj tryeze do të jenë gjyqtarët, prokurorët dhe policia gjyqësore. Çështjet të cilat do të diskutohen gjatë kësaj tryeze, kryesisht do të përqendrohen në procedurën e vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, provat e papranueshme dhe pranueshmëria e provave sipas KPPPK. Kjo tryezë do të përqendrohet në procedurën e provave e cila përfshinë të gjitha faktet të cilat gjykata i konsideron të rëndësishme për gjykim të drejtë të çështjes penale. Posaçërisht

kjo tryezë në formë bashkëbisedimi do të shtjellojë kushtet në të cilat është nxjerr një provë, kushtet ligjore të cilat i bëjnë provat të pranueshme apo të papranueshme si dhe shqyrtimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore përmes hapjes së diskutimeve interaktive. Kjo tryezë do të ndihmojë që pjesëmarrësit të avancojnë njohuritë e vlerësimit të provave.

Data e planifikuar: 17 prill 2007

Seminar: E drejta e Punës

Grupi përfitues: Gjyqtarët e lëmisë civile

Instituti Gjyqësor i Kosovës do të organizoj një seminar nga e drejta e punës, i cili do të mbahet në IGJK-së në Prishtinë. Temat të cilat do të shtjellohen gjatë punës së këtij seminari kryesisht do të përqendrohen në: Çështjet aktuale në lëmin e mardhënjes së punës në Shërbimin Civil të Kosovës, mardhënja e punës dhe karakteristikat e saj, të drejtat e punëtorëve me vështrim të posaqëm në aspektin e privatizimit të ndërmarrjeve dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave të punëtorve nga mardhënja e punës si dhe raste nga praktika gjyqësore.

Data e planifikuar: 19 prill 2007

Trajnimi për trajnues: Nivel i avancuar i trajnimit

Grupi përfitues: Trajnuesit e IGJK-së

Si pjesë e rëndësishme e strategjisë trajnuese, Instituti do të organizoj trajnimin e specializuar për

trajnues në Strugë të IRJM-së. Ideja prapa një trajnimi të tillë të trajnuesve është që trajnuesit të përmirësojnë shkathtësitë e tyre të mbajtjes së trajnimeve, duke zbatuar metodologjinë moderne për prezantime të sukseshme.

Qëllimi i këtij sesiioni të TIT-it është kontributi në përmbushjen e strategjisë afatgjatë trajnuese të IGJK-së - themelimi i ekipeve të trajnuesve me përvojë, të specializuar në mbajtjen e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të cilët do jenë në gjendje të plotësojnë nevojat në rritje e sipër të gjyqësorit të Kosovës sa i përket kualitetit të trajnimeve.

Data e planifikuar: 25-27 prill 2007

Trajnim i trajnuesve: Për Kodin e Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë

Grupi përfitues: trajnuesit (gjyqtarët dhe prokurorët)

Instituti Gjyqësor i Kosovës do të zhvilloj një punëtor "Trajnim i trajnuesve" për zhvillimin e një grupi të trajnuesve lokal (vendorë) të aftë që të zhvillojnë module trajnuese në të ardhmen në lëmin e Etikës për gjyqtar dhe prokurorë. Ky trajnim do të jetë i përqendruar në përgjegjësit dhe kërkesat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarët dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë. Kjo punëtor do të zhvillohet nga gjyqtarë ndërkombëtar dhe vendorë me përvojë. Qëllimi i këtij trajnimi do jetë edhe avancimi dhe përsosja e shkathtësive trajnuese të trajnuesve të rinj në lëmin e trajnimit.

Data e planifikuar: 30 prill 2007

BULETINI



INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

Kalendari i trajnimeve të IGJK-së PVAL prill 2007

E Hënë	E Marte	E Mërkure	E Enjte	E Premte	E Shtune	E Diel
2	3	4	5	6	7	8
Seminar mbi: Kodin e Etikës (Regjioni i Pejës)			Punëtori: Shqyrtimi praktik i një rasti penal	Seminar: Civile Ligji mbi familjen		
9	10	11	12	13	14	15
	Lëmia Penale Tryezë diskutimesh: Konfirmimi i aktakuzës		Regjioni i Prishtinës Seminar: Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut KE + IGJK	Regjioni i Prishtinës Seminar: Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut KE + IGJK		
16	17	18	19	20	21	22
	Lëmia Penale Tryezë diskutimesh: Procedura e provave		Lëmia Civile Seminar mbi: Të drejtën e punës			
23	24	25	26	27	28	29
		Trajnim i Trajnuesve	Trajnim i Trajnuesve	Trajnim i Trajnuesve		
30						
Trajnim i trajnuesve për Kodin e Etikës						